



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË / MINISTARSTVO ZDRAVSTVA / MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org. Jedinica Org Unit	01
Nr. i faqes Br. stranica No. of pgs	72 -
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	05-2203
Data: Datum:	24 / 03 / 2025
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Zyra e Ministrit- Ured Ministra -Office of the Minister

Nr: 21/III /2025

Datë: 24.03.2025

Ministri i Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 145, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në përputhje me nenet 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7, 01 Mars 2019), nenit 11 paragrafi 1.5 i Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive Shtojca 1 paragrafi 6 nënparagrafi 6.1, si dhe bazuar në nenin 5 të Ligjit Nr.08/L-220 për çmimin e produkteve medicinale lidhur me propozimin me nr. prot. 05 - 2160, datë 21.03.2024 të Komisionit për përcaktimin e çmimeve të produkteve medicinale, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Përditësohet Lista zyrtare e çmimeve të produkteve medicinale të deklaruara nga Bartësit e autorizim marketingut në Kosovë apo përfaqësuesit e autorizuar të Bartësit të autorizim marketingut e miratuar me Vendimin e Ministrit me nr. 05-10072, datë 23.12.2025 dhe Korigjuar me Vendimin e Ministrit me nr. 05-10256, datë 31.12.2025 sipas propozimit nr. prot. 05 - 2160, datë 21.03.2024 të Komisionit për përcaktimin e çmimeve të produkteve medicinale.
- II. Afati i vlefshmërisë së çmimeve të produkteve medicinale është i përcaktuar në Listën zyrtare të çmimeve të produkteve medicinale e cila është pjesë e këtij vendimi.
- III. Obligohen qarkulluesit me pakicë - barnatoret të vendosin çmimin në të gjitha produktet që kanë në gjendje sipas Listës së përditësuar e cila është pjesë e këtij vendimi.
- IV. Obligohet AKPPM të ndermerr të gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi;
- V. Përditësimi - Verzioni 1.1 i Listës zyrtare të çmimeve të produkteve medicinale është pjesë e këtij vendimi dhe e njëjta do të publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Agjencisë së Produkteve dhe Pajisjeve Medicinale.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetimi

Referuar shkresës nr.prot. 05- 2160, datë 21.03.2024 nga Komisioni për përcaktimin e çmimeve të produkteve medicinale, bazuar në dispozitat e nenit 5 të Ligjit Nr.08/L-220 për çmimin e produkteve medicinale, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Dr. Arben Vitia

Minister i Shëndetësisë



Vendim i dërgohet:

- *Zëvendësministrave të MSH-së;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Ud Kryeshefit të AKPPM-së;*
- *Znj. Virtyte Krasniqi, Kryesuese e Komisionit;*
- *Departamentit ligjor;*
- *Arkivit të MSh-së.*